

Intelligent Systems Albania shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 19

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	4,922,510	2,206,998
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	7,272,467	4,087,484
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	1,800,000	2,186,366
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	3,610,314	3,680,127
Total Aktive Afatshkurtra		17,605,291	12,160,975
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	374,006	498,675
Total aktive afatgjata		374,006	498,675
Total Aktive		17,979,297	12,659,650
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregëtare	9	2,879,063	2,808,400
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	10	4,444,860	3,978,294
Detyrime tatimore	11	1,831,833	1,055,043
Provizione	12	700,000	700,000
Të tjera detyrime	13	-	140,000
Total Detyrime afatshkurtra		9,855,756	8,681,737
Detyrime afatgjata			
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	3,411,957	3,483,040
Total Detyrime afatgjata		3,411,957	3,483,040
Totali i detyrimeve		13,267,713	12,164,777
Kapitali aksionar			
Kapitali i nënshkruar	15	2,000,000	2,000,000
Rezerva ligjore		51,120	51,120
Rezerva të tjera		(1,556,247)	1,896,071
Fitimi i ushtrimit		4,216,711	(3,452,318)
Total kapitali aksionar		4,711,584	494,873
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		17,979,297	12,659,650

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	23,526,861	13,942,220
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	(318,716)	(34,267)
			-
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(12,955,617)	(12,181,758)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	18	(10,595,100)	(9,174,574)
2) Të tjera shpenzime	19	(2,360,517)	(3,007,184)
			-
Shpenzime të personelit	20	(5,649,207)	(5,141,794)
1) Paga dhe shpërblime		(5,046,177)	(4,562,060)
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pension)		(603,030)	(579,734)
2) Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(124,669)	(36,757)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(76,957)	-
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare	22	71,480	38
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)		398	38
1) ekonomike brenda grupit			
2) Shpenzime të tjera financiare		71,082	-
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		4,473,175	(3,452,318)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23	(256,464)	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(256,464)	-
Fitimi/humbja e vitit		4,216,711	(3,452,318)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		4,216,711	(3,452,318)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"Intelligent Systems Albania" shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013	2,000,000		924,794	1,022,397	3,947,191
Fitimi / Humbja e vitit				(3,452,318)	(3,452,318)
Lëvizjet përmes kapitalit		51,120	971,277	(1,022,397)	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	2,000,000	51,120	1,896,071	(3,452,318)	494,873
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015					
Fitimi / Humbja e vitit				4,216,711	4,216,711
Lëvizjet përmes kapitalit			(3,452,318)	3,452,318	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	2,000,000	51,120	(1,556,247)	4,216,711	4,711,584

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori Intelligent Systems Albania shpk më 29.03.2016 dhe janë firmosur si më poshtë.

Elona Themeli

Elona THEMELI

Administrator

Monika Ferka

Hartuesi i Pasqyrave Financiare



**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	4,216,711	(3,452,318)
Shpenzimet financiare jomonetare	101,958	51,938
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	191,754	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	124,669	36,756
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(2,728,805)	1,989,299
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	1,122,265	108,967
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(140,000)	(16,247)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	2,888,552	(1,281,605)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(423,714)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-	(423,714)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	-	1,828,820
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	1,828,820
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	2,888,552	123,501
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	2,206,998	2,135,435
<i>Efkti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(173,040)	(51,938)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 4,922,510	2,206,998

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Intelligent Systems Albania" Shpk është rregjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë rregjistrave të Qendrës Kombëtare të regjistrimeve më 14 maj 2010 me NIPT L01714012M. Selia e shoqërisë është në "Rruga "Ismail Qemali", Pallati 27, Shk1 Nr. 30, Tiranë.

Kapitali i shoqërisë është 2,000,000 lekë.

Perfaqësuesi ligjor i shoqërisë është Znj. Elona Themeli.

Ortakët e shoqërisë janë përkatësisht:

- Investment SHERKO - ikub GROUP shoqëri e cila zotëron 49% të kuotave të kapitalit dhe
- INTELLIGENT SYSTEMS BULGARIA LTD shoqëri e huaj e cila zotëron 51% të kuotave të kapitalit.

Aktiviteti i shoqërisë është kryerja e shërbimeve të konsulencës në fushën e teknologjisë së informacionit (IT), të organizojë trajnime, të shesë dhe të implementojë sisteme të teknologjisë së informacionit, kryesisht me fokus në produktet e Microsoft Dynamics, të importojë dhe të eksportojë mallra, materiale, dhe shërbime, sikurse përcaktohet në këtë dokument ligjor, dhe cdo veprimtari në lidhje me to, dhe cdo aktivitet ekonomik që do të konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm në mënyrë që të përmbushet qëllimi i veprimtarisë, dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria kishte 3 punonjës (2014: 3 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të

arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/LEK	137.28	140.14
USD/ LEK	125.79	115.23
GBP/LEK	186.59	179.48

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.2. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e

blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si

provizion, nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Mjete monetare ne banke	4,674,198	1,967,573
Llogari rrjedhese	4,674,198	1,967,573
Mjete monetare ne arke	248,312	239,425
	<u>4,922,510</u>	<u>2,206,998</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregëtare

Llogaritë e arkëtueshme tregëtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Kliente	7,272,467	4,087,484
	<u>7,272,467</u>	<u>4,087,484</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
IkubInfo Software Solutions shpk	1,800,000	1,800,000
Intelligent Systems Bullgaria	-	386,366
	<u>1,800,000</u>	<u>2,186,366</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Debitore te tjere	3,470,314	3,470,314
Garanci per qera	140,000	140,000
Tatim Fitimi	-	69,813
	<u>3,610,314</u>	<u>3,680,127</u>

(Vlerat janë në Lek)

8. Aktive Afatgjata Materiale

	Paisje kompjuterike	Totali
Kosto		
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	264,812	264,812
Shtesa	423,714	423,714
Nxjerrje jashtë përdorimit		0
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	688,526	688,526
Shtesa		0
Nxjerrje jashtë përdorimit		0
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	688,526	688,526
Zhvlerësimi i akumuluar		
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	(153,094)	(153,094)
Amortizimi i vitit	(36,757)	(36,757)
Nxjerrje jashtë përdorimit		0
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	(189,851)	(189,851)
Amortizimi i vitit	(124,669)	(124,669)
Nxjerrje jashtë përdorimit		0
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	(314,520)	(314,520)
Vlera neto kontabël		
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	111,718	111,718
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	498,675	498,675
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	374,006	374,006

9. Llogari të pagueshme tregëtare

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2015 dhe 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Furnitore vendas	2,876,645	2,637,879
Furnitore per fatura te pa mberitura	2,418	170,521
	<u>2,879,063</u>	<u>2,808,400</u>

10. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Të pagueshme tregtare Intelligent Systems Bullgaria	342,330	-
Të pagueshme tregtare IKUB.AL	46,752	78,809
Të pagueshme tregtar ikubINFO Software Solutions shpk	576,182	419,889
Të pagueshme të tjera ikubINFO Software Solutions	3,479,596	3,479,596
	<u>4,444,860</u>	<u>3,978,294</u>

11. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	84,494	81,736
Tatimi mbi te Ardhurat nga Punesimi	129,579	74,698
Tatim ne Burim	419,992	-
Tatim fitimi	121,941	-
TVSH per t'u paguar	1,075,827	898,609
	<u>1,831,833</u>	<u>1,055,043</u>

12. Provizione

Provizionet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
	<u>ne Lek</u>	<u>ne Lek</u>
Provizione	700,000	700,000
	<u>700,000</u>	<u>700,000</u>

13. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Detyrime ndaj personelit	-	140,000
	<u>-</u>	<u>140,000</u>

14. LLogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Në këtë zë janë paraqitur huate afatgjata nga Ortaku Intelligent Systems Bulgaria ltd. Më poshtë janë paraqitur këto hua me 31 dhjetor 2015 dhe 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Financim nga Ortaku-Intelligent Systems Bulgaria LTD	3,411,957	3,483,040
	<u>3,411,957</u>	<u>3,483,040</u>

15. Kapitali aksionar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 2,000,000 Leke, perkatesisht:

- Investment SHERKO - ikub GROUP shoqeri e cila zoteron 49% te kuotave te kapitalit dhe
- INTELLIGENT SYSTEMS BULGARIA LTD shoqeri e huaj e cila zoteron 51% te kuotave te kapitalit.

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga shërbimet	23,526,861	13,942,220
	<u>23,526,861</u>	<u>13,942,220</u>

17. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera financiare detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Fitime nga këmbimet valutore	342,090	214,529
Humbje nga këmbimet valutore	(660,806)	(248,796)
	<u>(318,716)</u>	<u>(34,267)</u>

Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar në FDP e TVSH është si më poshtë:

	Dhjetor 31, 2015
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	23,526,861
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	23,526,861
Shitje shërbime	23,526,861
Të ardhura të deklaruara në Pash të cilat janë deklaruar shitje në FDP	23,526,861
Të ardhurat nga interesat	398
Fitim nga këmbimet valutore	413,173
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Ftimit	23,940,431

18. Lëndet e para dhe shërbimet

Shërbimet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 dhe atë të mbyllur më 31 Dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Nënkontraktme	10,595,100	9,174,575
	10,595,100	9,174,574

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë përvitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime qeraje	1,117,102	1,284,850
Shpenzime administrative dhe noteriale	3,100	1,210
Konsulenca ekonomike dhe juridike	180,051	255,080
Shërbime të tjera	55,355	11,160
kanceleri	1,080	11,438
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	52,644	39,216
Komisione bankare	80,351	110,735
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	173,193	115,647
Dhurata	44,523	67,431
Taksa të ndryshme	25,120	25,120
Humbje nga rivlerësimi	-	(1,083)
Siguracione	8,408	-
Shpenzime për pritje	10,000	-
Reklama, publicitet	552,950	653,028
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	56,640	433,352
	2,360,517	3,007,184

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për paga	4,649,844	4,382,747
Shpërblime për punonjësit	396,333	179,313
Shpenzime për sigurime shoq e shënd	603,030	579,734
	5,649,207	5,141,794

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 3 (2014:3).

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Gjoha dhe penalitete	76,957	-
	76,957	-

22. Shpenzime financiare Neto

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për interesa	-	(352)
Të ardhura nga interesat	398	390
Humbje nga këmbimet valutore	-	-
Të ardhura nga këmbimet valutore	71,082	-
	71,480	38

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2014;15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	4,473,175	(3,452,318)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	188,120	500,784
Shpenzime pritje & përcjellje	10,000	
Shpenzime udhëtimi		28,098
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	76,957	
Shpenzime të viteve të kaluara		377,461
Shpenzime të tjera	101,163	95,225
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	4,661,295	(2,951,534)
Humbje fiskale e mbartur	(2,951,534)	
Rezultati Fiskal	1,709,761	(2,951,534)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	256,464	-
Rezultati Vitit	<u>4,216,711</u>	<u>(3,452,318)</u>

24. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

Bilanci kontabël	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
<i><u>Të arkëtueshme nga palëve të lidhura</u></i>		
IkubInfo Software Solutions shpk	1,800,000	1,800,000
Intelligent Systems Bullgaria	-	386,366
	<u>1,800,000</u>	<u>2,186,366</u>
<i><u>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</u></i>		
Intelligent Systems Bullgaria	3,754,287	3,483,040
IKUB.AL	46,752	78,809
ikubINFO Software Solutions shpk	4,055,778	3,899,485
	<u>7,856,817</u>	<u>7,461,334</u>
	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
<i><u>Shitje palëve të lidhura</u></i>		
Intelligent Systems Bullgaria	353,452	384,852
	<u>353,452</u>	<u>384,852</u>
<i><u>Blerje nga palët e lidhura</u></i>		
Intelligent Systems Bullgaria	1,285,248	-
ikub.al	574,056	686,109
ikubINFO Software Solutions	130,244	353,406
	<u>1,989,548</u>	<u>1,039,515</u>

25. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.